



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.61/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.02.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Pienvi” shpk në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr.REF-38097-12-14-2017 me objekt “*Rikonstruksioni i Muzeut Historik Sinje*” me fond limit 8 446 818.82(tete milion e katerqind e dyzete e gjashte mije e teteqind e tetemdhjete presje tetedhjetë e dy) leke pa tvsh vlere e plote dhe 381 617 (treqind e tetedhjetë e nje mije e gjashteqind e shtatembedhjetë) leke pa tvsh vlere pjesore per vitin 2017 vene ne dispozicion nga buxheti i Bashkise Berat, zhvilluar në datë 26.12.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

Ankimues:

“Pienvi” shpk
Rruga “Bardhok Biba”, ish kinema 17 Nëntori Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Berat
Lagjia “Iliria”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave

nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” , i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.12.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-38097-12-14-2017 me objekt “Rikonstruksioni i Muzeut Historik Sinje” me fond limit 8 446 818.82(tete milion e katerqind e dyzete e gjashte mije e teteqind e tetemdhjete presje tetedhjete e dy) leke pa tvsh vlere e plote dhe 381 617 (treqind e tetedhjete e nje mije e gjashteqind e shtatembdhjete) leke pa tvsh vlere pjesore per vitin 2017 vene ne dispozicion nga buxheti i Bashkise Berat, zhvilluar në datë 26.12.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

II.2. Në datën 26.12.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar Informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 31.12.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Fled	pa ofertë	I skualifikuar
- Elira&Anada	5,735,061	I skualifikuar
- Colombo	5,956,978	I skualifikuar
- Ngracan	6,158,331	I skualifikuar
- Sark	6,310,249.5	I skualifikuar
- Shendelli	6,340,923	I skualifikuar
- Shamo Konstruksion	6,529,649.4	I skualifikuar
- Pienvis	7,634,330	I skualifikuar
- Saimiri Grup 1981	8,060,561,50	I kualifikuar

II.4. Në datën 12.01.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Fled	pa ofertë	I skualifikuar
- Elira&Anada	5,735,061	I skualifikuar
- Colombo	5,956,978	I skualifikuar
- Ngracan	6,158,331	I skualifikuar
- Sark	6,310,249.5	I skualifikuar
- Shendelli	6,340,923	I skualifikuar
- Shamo Konstruksion	6,529,649.4	I skualifikuar
- Pienvis	7,634,330	I skualifikuar
- Saimiri Grup 1981	8,060,561,50	I kualifikuar

II.5. Referuar Informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 31.12.2017 operatori ekonomik “Pienvis” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- Ing Elektrik Sh.Sh. i mungon kontrata e punës
- Ing elektrik Sh. Sh. i mungon në listpagesën e muajit gusht 2017
- Mungon Set për ndihmën e shpejtë

II.5. Në datën 05.01.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Kundërshtojmë arsyet e skualifikimit konkretisht për Ing Elektrik në licencën profesionale të vjetër të OE Pienvis shpk figuron Sh. Sh. Ky drejtues teknik në muajin Korrik 2017 është larguar nga shoqëria Pienvis shpk dhe në vend të tij është kontraktuar D. B. Kjo reflektohet në licencën e re profesionale të shoqërisë të paraqitur në sistem. Pra kërkesa kontratë pune të vlefshme është plotësuar nga Ing D. B. Kërkesa e vlefshme do të thotë që ky specialist është në vazhdim të punësimit në këtë shoqëri dhe i vlefshëm për periudhën e kryerjes së punimit në këtë objekt. Kontrata e punës e Ing Sh. Sh. nuk është paraqitur me arsyen se nuk është më e vlefshme për periudhën e ndërtimit të objektit në fjalë. Paraqitja e dokumentave të tjera për Ing Elektrik Sh. Sh. si (diploma, Cv) si dhe qenia në listpagesa deri në muajin Qershor 2017 kur dhe është momenti i largimit, vërteton zbatimin e rregullave nga kjo shoqëri në fushën e punësimit dhe jo informalitet.
- Lidhur me arsyen e skualifikimit mungon seti i ndihmës së shpejtë sqarojmë se është paraqitur në sistem fatura e tvsh nr.2969 dt 25.03.2015 ku bashkëngjitur kësaj fature është fatura e artikujve të blerë nga Albig EA” shpk dhe në Nr.3 të kësaj liste artikujsh është kutia e ndihmës së shpejtë copë 20.
- Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se në licencën profesionale të vjetër të OE Pienvis shpk figuron Ing. Elektrik Sh. Sh. Ky drejtues figuron në listpagesat e shoqërisë Pienvis shpk nga Janari 2016- Qershor 2017 dhe në muajin korrik 2017 është larguar nga shoqëria jonë dhe në vend të tij është kontraktuar Ing. D. B. Kjo reflektohet në licencën e re profesionale të shoqërisë të paraqitur në sistem si dhe listpagesën e shoqërisë Korrik 2017 deri shtator 2018 Ing D. B.
- Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.

II.6. Referuar Informacionit të autoritetit kontraktor sqarohet se: Në datën 05.01.2018 pranë Bashkisë Berat është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik Pienvis shpk me shkresën nr.40 prot. Komisioni e ka shqyrtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik duke i pranuar të gjitha pikat e ankesës. Përpara bërjes së rivlerësimit në sistem për operatorin ekonomik që paraqiti ankesën anëtarët e KVO-së e ripanë dhe njëherë të gjithë dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik nga OE Pienvis shpk dhe gjetën këto mangësi:

- Disa nga drejtuesve teknikë paga në kontratë nuk i përputhej me deklaratimet në listpagesa konkretisht: Ing A. L.; Ing R. H.; Ing T.Q.; Ing E. B.; Anëtarët e KVO bënë rivlerësim në sistem duke lënë të skualifikuar operatorin ekonomik Pienvis shpk me arsyet e sipërcituara.

II.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se më datë 12.01.2018 operatori ekonomik “Pienvis” shpk është njoftuar elektronikisht për rivlerësimin e ofertave si dhe riskualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- disa nga drejtuesve teknik paga në kontratë nuk i përputhej me deklaratimet në listpagesa konkretisht: Ing A.L.; Ing R.H.; Ing T. Q.; Ing E. B.;

II.8. Në datën 15.01.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjten objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr.282/1 prot., datë 23.01.2018 protokolluar me tonën me nr.54/2 datë 25.01.2018 me objekt “*Dërgohet informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Pienvi” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Ing Elektrik Sh. Sh. i mungon kontrata e punës; Ing elektrik Sh. Sh. mungon në listpagesën e muajit gusht 2017; Mungon Set për ndihmën e shpejtë*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar Informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 31.12.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Fled	pa ofertë	I skualifikuar
- Elira&Anada	5,735,061	I skualifikuar
- Colombo	5,956,978	I skualifikuar
- Ngracan	6,158,331	I skualifikuar
- Sark	6,310,249.5	I skualifikuar
- Shendelli	6,340,923	I skualifikuar
- Shamo Konstruksion	6,529,649.4	I skualifikuar
- Pienvi	7,634,330	I skualifikuar
- Saimiri Grup 1981	8,060,561,50	I kualifikuar

III.1.2. Në datën 12.01.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Fled	pa ofertë	I skualifikuar
- Elira&Anada	5,735,061	I skualifikuar
- Colombo	5,956,978	I skualifikuar
- Ngracan	6,158,331	I skualifikuar
- Sark	6,310,249.5	I skualifikuar

- Shendelli	6,340,923	I skualifikuar
- Shamo Konstruksion	6,529,649.4	I skualifikuar
- Pienvi	7,634,330	I skualifikuar
- Saimiri Grup 1981	8,060,561,50	I kualifikuar

III.1.3.Referuar Informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 31.12.2017 operatori ekonomik “Pienvi” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- Ing Elektrik Sh. Sh. i mungon kontrata e punës
- Ing elektrik Sh.Sh. mungon në listpagesën e muajit gusht 2017
- Mungon Set për ndihmën e shpejtë

III.1.4. Referuar Informacionit të autoritetit kontraktor sqarohet se: Në datën 05.01.2018 pranë Bashkisë Berat është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik Pienvi shpk me shkresën nr.40 prot. Komisioni e ka shqyrtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik duke i pranuar të gjitha pikat e ankesës. Përpara bërjes së rivlerësimit në sistem për operatorin ekonomik që paraqiti ankesëmn anëtarët e KVO-së e ripanë dhe njëherë të gjithë dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik nga OE Pienvi shpk dhe gjetën këto mangësi:

- Disa nga drejtuesve teknikë paga në kontratë nuk i përputhej me deklaratimet në listpagesa konkretisht: Ing A. L., Ing R.H., Ing T. Q., Ing E. B. Anëtarët e KVO bënë rivlerësim në sistem duke lënë të skualifikuar operatorin ekonomik Pienvi shpk me arsyet e sipërcituara.

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se më datë 12.01.2018 operatori ekonomik “Pienvi” shpk është njoftuar elektronikisht për rivlerësimin e ofertave si dhe riskualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- disa nga drejtuesve teknik paga në kontratë nuk i përputhej me deklaratimet në listë pagesa konkretisht: Ing A. L., Ing R.H., Ing T.Q., Ing E. B.

III.1.6. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.” Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”. Në nenin 63,

pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përgjegjësimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënjën e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të

garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së.

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar si dhe fakteve të ndodhura sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se rivlerësimi i procedurës i datës 12.01.2018 dhe rishqyrtimi i të gjithë dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues “Pienvis” me argumentat se “Komisioni e ka shqyrtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik duke i pranuar të gjitha pikat e ankesës. Përpara bërjes së rivlerësimit në sistem për operatorin ekonomik që paraqiti ankesëmn anëtarët e KVO-së e ripanë dhe njëherë të gjithë dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik nga OE Pienvis shpk dhe gjetën këto mangësi: Disa nga drejtuesve teknikë paga në kontratë nuk i përputhej me deklaratimet në listpagesa konkretisht: Ing A. L., Ing R. H., Ing T.Q., Ing E. B. Anëtarët e KVO bën rivlerësim në sistem duke lënë të skualifikuar operatorin ekonomik Pienvis shpk me arsyet e sipërcituara”, është tërësisht i gabuar.

KPP referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konstaton se në të pranohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Pienvis” shpk lidhur me skualifikimin e ofertës së tij me datë 31.12.2017 është pranuar tërësisht.

Në rastin konkret KPP gjykon se në momentin e pranimi të ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga KSHA autoriteti kontraktor duhet të vijonte me rivlerësimin e procedurës duke kualifikuar operatorin ekonomik ankimues “Pienvis” shpk dhe jo të rishqyrtonte dokumentacionin e këtij të fundit nga e para, në kuptim të nenit 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se: *[...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.*

Në interpretim literal të dispozitës së sipërcituar i vetmi detyrim i autoritetit kontraktor pas pranimi të ankesës së operatorit ekonomik ankimeus është adresimi i vendimit të KSHA për zbatim tek KVO-ja.

Komisioni gjykon se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka për kompetencë të vetën funksionale shqyrtimin në tërësi të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dhe njoftimin e operatorëve ekonomikë për të gjitha arsyet e mundshme të skualifikimit, në mënyrë që këta të fundit të kenë mundësi të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me motivet e skualifikimit dhe të rivendosin të drejtat e tyre nëpërmjet procesit të ankimit, sikundër parashikohet në pikën 2, neni 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar si dhe në pikën 5, të nenit 78 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Pas

kësaj i takon KSHA shqyrtimi i ankesave duke disponuar me pranimin ose jo të tyre. Në rastin konkret arsyet e skualifikimit të komunikuar rregullisht ankimesit janë ato të datës 31.12.2017, ndërsa cdo arsye tjetër që i është komunikuar pas kësaj date dhe që ka ardhur kryesisht nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se bie ndesh me legjislacionin e prokurimit publik.

Referuar sa më sipër KPP arrin në përfundimin se rivlerësimi i procedurës dhe rishqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Pienvi” shpk pas pranimin të ankesës së paraqitur nga ky i fundit dhe riskualifikimi i tij, është bërë në përfundim të afateve të ankimit administrativ në kundërshtim të plotë me procedurën e vlerësimit të ofertave. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendime të tilla, “të reja”, të evidentuara në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit për prokurimin publik nuk mund të merren në shqyrtim.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pienvi” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-38097-12-14-2017 me objekt “Rikonstruksioni i Muzeut Historik Sinje” me fond limit 8 446 818.82(tete milion e katerqind e dyzete e gjashte mije e teteqind e tetemdhjete presje tetedhjete e dy) leke pa tvsh vlere e plote dhe 381 617 (treqind e tetedhjete e nje mije e gjashteqind e shtatembdhjete) leke pa tvsh vlere pjesore per vitin 2017 vene ne dispozicion nga buxheti i Bashkise Berat, zhvilluar në datë 26.12.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së datë 12.01.2018 mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Pienvi” shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pienvi” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 54 Protokolli, Datë 15.01.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha